



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:258249

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06454030

**Në ankesën e**

**AC-I-24-0752**

**Paditësi**

**Sh R H** nga fshati D komuna Podujevë , përfaqësuar përmes avokatit B I, Prishtinë.

**Kundër**

**E paditura/Ankuesja**

**NSH.FAN "Zahir Pajaziti"**, e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5960 të datës 9 shtator 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 nëntor 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5960 të datës 9 shtator 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 26 gusht 2014, paditësi e ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN046-0123 të datës 21 korrik 2014, me të cilin Autoriteti i Likuidimit, e kishte refuzuar kërkesën e tij për 3 paga të fundit të pa paguara në shumë prej 510.00 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi pohon se ai dhe punëtorët e tjerë të ndërmarrjes ishin pre e ndërprerjes masive të marrëdhënies së punës nga ndërmarrja andaj ai ka të drejtë në 3 pagat e fundit të pa paguara, bazuar në nenin 40.1.6.1 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së. Bashkë me ankesë paditësi ka bashkangjitur Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0123 të datës 21 korrik 2014, kopjen e Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Listën e pagave për tre muajt e fundit të papaguara.

Me datë 26 maj 2020, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë për rregullim të padisë, në të cilën ai ka kërkuar, që në emër të tri pagave të fundit të papaguara ti kompensohet shuma prej 510.00 euro, në emër të interesit ligjor prej 10 % të borxhit kryesor shumë prej 51.00 në emër të shpenzimeve të përfaqësimit ti kompensohet shuma prej 312 euro, si dhe ti kompensohen pagesa e taksës në shumë prej 20 euro.

Me datë 2 gusht 2024, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë ka propozuar që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i AKP-së. AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja ka pohuar se paditësi ka dështuar të tregoi se cila dispozitë ligjore është shkelur me Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Tutje në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohon se kërkesa për kompensim të pagave nga muaji janar deri mars 2006 është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi ka dështuar të paraqet prova në gjykatë se ai i ka kërkuar këto paga brenda 3 viteve në Gjykatën kompetente. AKP-ja pohon se afati i fundit më i vonshëm i parashkrimit të kërkesës ishte muaji

mars 2009. Prandaj nga këto arsye me të drejt Autoriteti i Likuidimit e kishte refuzuar kërkesën e paditësit për kompensimin e këtyre pagave.

Me datë 9 shtator 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-14-5960, e aprovoi ankesën e paditësit si bazuar, e ndryshoi vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0123 të datës 21 korrik 2024, si dhe e obligoi AKP-në ti paguaj paditësit 3 pagat e fundit të papaguara në shumë prej 510.00 euro, interesin ligjor prej 10% në shumë prej 51 euro, shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit prej 104, që do të paguhet sipas prioritetit të përcaktuar me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi ishte një punëtor i NSH Fan "Zahir Pajaziti" në Podujevë i cili ka pretenduar se ka qenë punëtor i saj deri në momentin e privatizimit me 24 mars 2006. Tutje Shkalla e I-rë ka konstatuar me njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës vërtetohet se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në ditën e privatizimit të NSH-së. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se e paditura nuk e ka kontestuar përvojën e punës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar nga ankuesi. Ankuesi kërkesën e ka mbështet, në Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe në Listën e pagave për periudhën janar-mars 2006 e lëshuar nga shërbimi financiar i ndërmarrjes. Lartësia e kompensimit nuk kontestohet shprehimisht nga AKP-ja. Andaj nga këto arsye, shkalla e I-rë e DHPGJS-së konstaton se paditësi i ka përmbushur kushtet ligjore nga neni 40.1.6.1 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së që ti njihet e drejta në pagesën e tri pagave të fundit të papaguara që do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Me datë 30 shtator 2024, e paditura e dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-5960 të datës 9 shtator 2024, për shkak të vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes të dispozitave të së drejtës materiale dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, ashtu që të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0123 i datës 21 korrik 2014. Për më tepër në ankesë e paditura ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor

për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar- afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja pretendon se kërkesa për 3 paga të fundit të papaguara është dashtë të paraqitet deri në mars 2009, ndërsa kërkesa është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me 20 shtator 2013, që nënkupton se kërkesa është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me datë 15 tetor 2024 paditësi e pranoi ankesën e AKP-së, mirëpo nuk ka parashtruar përgjigje në këtë ankesë.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se Autoriteti i Likuidimit pran AKP-së e ka refuzuar si të pa vlefshme, kërkesën e paditësit për kompensimin e 3 pagave të fundit të pa paguara nga muaji janar e deri në muajin mars 2006, në shumë prej 510.00 euro, me arsyetimin se kërkesa e paditësit për këto 3 paga, është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit ka vërejtur që Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, e ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe e ndryshoi vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0123 të datës 21 korrik 2014, si dhe e obligoi AKP-në ti paguaj paditësit 3 pagat e fundit të papaguara në shumë prej 510 interesin ligjor prej 10%

në shumë prej 51 euro, si dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit prej 104 euro, e cila do të paguhet sipas prioritetit të përcaktuar me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit duke u bazuar në provat që ekzistojnë në dosje të Shkallës së I-rë, nuk mund të pajtohet me konstatimin e gabuar të Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për këto 3 paga është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në procedurën pranë shkallës së I-rë të DHPGJS-së, ai ka sjellë Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Ky dokumente vërteton se është ndërprerë afati i parashkrimit të kërkesës. Në bazë të këtij dokumenti, atë ditë është shitur Ndërmarrja në bazë të vendimit të Bordit të ish AKM-së, dhe marrëdhënia e punës ankuesit i është ndërprerë menjëherë.

Paditësi duke u bazuar në këtë Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, ka pritur të filloj procedura e likuidimit ndaj NSH-së, dhe pastaj të paraqesë kërkesën për paga. Paditësi në afatin ligjor ka paraqitur kërkesën e tij tek Autoriteti i Likuidimit me datë 20 shtator 2013. Andaj nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi po ashtu ka sjellë me parashtresën e datë 26 maj 2020, një kopje të listës së pagave të pa paguara për periudhën janar e deri në mars 2006, e cila listë është nënshkruar nga menagjmenti i NSH-së dhe është vulosur me vulën e NSH-së.

Prandaj duke u bazuar në këto prova, Kolegji i Apelit vjen në përfundim se paditësi ka të drejtë ti paguhet kompensimi për 3 pagat e fundit të pa paguara në periudhën e cekur ne shume prej 510.00 euro, në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Borxhi kryesor në shumë prej 510.00 euro lidhur me 3 pagat e fundit të pa paguara, si dhe interesi ligjor prej 10 % të borxhit kryesor në shumë prej 51.00 euro që do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e Likuidimit.

Andaj duke u bazuar në këto arsye, refuzohet ankesa e të paditurës si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë taksën gjyqësore për procedurën ankimore e ka paguar me datë 11 tetor 2024 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 nëntor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_